




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DECANIT  
MUNICIPALITY OF DECAN  
OPSTINA DECAN



## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

631-24-5919-2-2-1/C281

**KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;  
dhe

**ELEKTROMONT DI SH.P.K., Deçan, Deçan**, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjeter, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për Shërbimet në vijim:

Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe institucioneve publike në Deçan me numër identifikues: **631-24-5919-2-2-1** me nr. Të bren. Të prok. 631 24 016 221.

Neni 1                    Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

**Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe institucioneve publike në Deçan**

Nr.	Grupi
1	<b>Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe institucioneve publike në Deçan</b>

[Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet]

[Përdorimi i kësaj kontrate publike kornizë është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet Kontraktuese të specifikuara në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjeter Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosine" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(i) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i të detyruar të përdorë/ni këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me [18.07.2024] dhe përfundon në datën [18.07.2024].

#### Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 5 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Komuna e Deçanit.

[Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes se Tendentit]

#### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofriuesi i Shërbimeve.

Vlera e përgjithshme e parashikuar është 120.000,00 Euro.

Vlera totale indikative e kontratës me qnim të peshuar për njësi është 90,19 Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [mostejkalimi i vlerës substanciale të kontratës].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagëse që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofriuesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vëndosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 PageSAT do të bëhen në përpüthje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqantit të Kontratës.

#### Neni 4 Rendi i përparsisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veqantit të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofriuesit te Shërbimeve, duke përfishirë Specifikimet Teknikë;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); 03.07.2024
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbjijnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër; dhe në raste të paqartësise ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparsisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofriuesit te Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, fiks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të

pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëfqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëfqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsyet.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet shqipe në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Xhevdet Ramosaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	18.07.2024
Vula:	



#### Për Ofruesin e Shërbimeve

Emri:	Driton Iberhysaj
Pozita:	Drejtësor
Nënshkrimi:	
Data:	18.07.2024
Vula:	

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palet, duke përfshire të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me reference në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshtimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palet në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përsaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshire edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palet" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palet" nënkuption të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkuption autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohej në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkuption Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet paletëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferoje kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përshtitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shurnave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontrates; ose
  - b) në rast të dhënies se të drejtës se Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kerkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitive të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshme që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimt te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmëroj Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditës pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmibushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përpunhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshire në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizoje çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritur të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonësë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet te fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonësë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të perfundoj aktivitetet veprimtar brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i perfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Perfundimit do të jetë data e perfundimit të të gjitha aktiviteteve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, përdonjëren nga këto arsyet:

- a) dëshimi i Autoritetit Kontraktues për të përmibushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit përmes së cilës ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvësje kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollesive të permendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njostimit me shkrim do t'i lejoj Ofriuesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë dhe retrospektive, ose të informoj Ofriuesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njostimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë vëprimet e zoftit, goditjet, imbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, vëprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemite, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vëtetëma, vërshtimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjeter e ngjashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të paleve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paafësinë e një pale të tillë që të përbushet detyrimet e saj tanj e tuje me një vonesë minimale.

8.4. Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështrimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështrimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjidjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofriuesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktikë, dhe të angazhojë të gjitha mijetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofriuesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mijete të tillë alternative përvèç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i jep Ofriuesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofriuesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë negligencë apo dëshrim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofriuesi i Shërbimeve refuzon ose është negligent në realizimin e urdhërave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofriuesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontraten apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofriuesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u imbyllur, punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronet procedurave ligjore lidhur me ato çeshtje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në regjuloret nacionale;
- (e) Ofriuesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fiqinë e *res judicata*;
- (f) Ofriuesi i Shërbimeve është shpalitur fajtor për sjellje të rendë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjeter ligjore që i pengon realizimin të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjeter me një pale të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgjedhur në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguaje shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërtet kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndëprese kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguaje Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdinisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjeter sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguaje Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai,

duke ju ekspozuar dënimit për shikelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofroesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendore të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjëve dhe rregulloreve.

11.4 Ofroesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të bolojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofroesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlgimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofroesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performance-s, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe astësia në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

## Neni 12            Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofroesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofroesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në menyre të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13            Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofroesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limateve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrëse dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofroesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofroesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të paraparë në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofroesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokauruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performance-s;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofroesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofroesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofroesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

*b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

*c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njofojt Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

*a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetave tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njofojt Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

**Neni 14      Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri, për ekzekutim, të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

**Neni 15      Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktoret të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, pör në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, sic do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

**Neni 16      Parametët përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se leshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi.

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjetet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bunkare.

16.2 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorezuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspeksion i menjehershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të jepë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhiënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, osc të mos e realizojë kontraten, ose ta ndërpresë atë, me parafajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-në për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

#### Neni 17                   Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do tëjenë si në KV.K. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhezojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KV.K.

#### Neni 18                   Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njofsimin e Autoritetit Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të pagujë këtë shumë, dhe do pasoj një dënim përmes Ekokomisionit që llogaritet siç përshtruhet në nenin 13.1.

#### Neni 19                   Konsekuenca e Shkeljeve kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontraten nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dënituar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërpërje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbutur nga shumat që duhet t'i pagulhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetër me shkrim pér qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhë pér ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shih të dobishme, palët do të takohen dhë të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës per zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet pér arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja pér të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave per zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetër.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arritet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arritet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore pér zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin pér mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### Neni 22 Dëmshpërbimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhë do te dëmshpëblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhë agentet e tij dhe do te jetë përgjegjës pér te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhë pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përlshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhë shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësise intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VECANTA

631-24-5919-2-2-1/C281

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës	Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është <b>[19.07.2024]</b> .
	6.4	Data e Përfundimit është <b>[19.07.2027]</b> .
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <b>[Komuna e Deçanit]</b>
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <b>[Caktohet me vendim të ZKA]</b>
Dëmet likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi shërbimeve	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të janë:  a) Përgjegjësia e Palës së Tretë <b>[shëno shumën]</b> b) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <b>[shëno shumën]</b> c) Përgjegjësia profesionale <b>[shëno shumën]</b> d) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <b>[shëno shumën]</b>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për shërbimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Kontrolli	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti


kualitetit		<p>kontraktues do të jenë si në vijim: [nga menaxheri i kontratës]</p> <p>Periudha Garantuese e Defekteve është [shëno datën]</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<p><i>Njisija e kërkuese përmes një komisioni duhet të bëj përpjekje të zgjedhjes të mosmsrrëveshjeve me kryesin e sherbiueve.</i></p>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore	21.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Trëgtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

PËRSHKIMI I ÇMMIVE

Nr.	TITULLI : Mirembajta e ndriçimit publik në Komunën e Dëbarit, për vitin 2024 - deri me 2026	PIESA-A) (50%)				
		Njësi	Sasia	Cmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali i mbiqesave (50% e pikave per vlerasim).	Totali i me TVSh-€
1	PIESA-A:					
1	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike H=9m (të galvanizuar) forma trethore me reduktim.	Copë	1	€ 20.00	€ 20.00	
2	Furnizimi dhe montimi i shtyllave metalike H=5-6m (të galvanizuar) forma trethore	Copë	1	€ 15.00	€ 15.00	
3	Furnizimi dhe montimi i laveve (të galvanizuar) nje ktheshe	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
4	Furnizimi dhe montimi i laveve (të galvanizuar) dy ktheshe	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
5	Furnizimi dhe montimi i laveve - mbajse seve të trupave ndriçues neper shtylla të druri dhe të betonit	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçues me karakteristika minimale: Fuga e LED-it: 80W Tensioni punës: 220-240 V AC, 50/60 Hz. Puna në temperaturë: -30°C deri +50°C Ndriçuesi i LED-it: ≥150 lm/W CRI: Ra≥70 Faktori i fuqisë ≥0.95 Ngjyra e temperaturës -Natyrale:4000K Mbrojtja ≥ IP66 Rezistencë minime ndaj ndikimit ≥IK08 Garancioni ≥ 5 vite Materiali: Alumin i derdhur, ngjyra e trupit ndriçues :black, silver ose gray Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h Mbrojtja nga mbrojtjeni ≥6KV Sistemi Optik nga PMMA	Copë	1	€ 10.00	€ 10.00	
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçues me karakteristika minimale: Fuga e LED-it:80W Tensioni punës: 220-240 V AC, 50/60 Hz. Puna në temperaturë: -30°C deri +50°C Ndriçuesi i LED-it: ≥150 lm/W CRI: Ra≥70 Faktori i fuqisë ≥0.95 Ngjyra e temperaturës -Natyrale:4000K Mbrojtja ≥ IP66 Rezistencë minime ndaj ndikimit ≥IK08 Garancioni ≥ 5 vite Materiali: Alumin i derdhur, ngjyra e trupit ndriçues :black, silver ose gray Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h Mbrojtja nga mbrojtjeni ≥6KV Sistemi Optik nga PMMA	Copë	1	€ 10.00	€ 10.00	
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçues me karakteristika minimale: Fuga e LED-it:80W Tensioni punës: 220-240 V AC, 50/60 Hz. Puna në temperaturë: -30°C deri +50°C Ndriçuesi i LED-it: ≥150 lm/W CRI: Ra≥70 Faktori i fuqisë ≥0.95 Ngjyra e temperaturës -Natyrale:4000K Mbrojtja ≥ IP66 Rezistencë minime ndaj ndikimit ≥IK08 Garancioni ≥ 5 vite Materiali: Alumin i derdhur, ngjyra e trupit ndriçues :black, silver ose gray Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h Mbrojtja nga mbrojtjeni ≥6KV Sistemi Optik nga PMMA	Copë	1	€ 10.00	€ 10.00	
9	Furnizimi dhe vendosja e kabllos XOO/O-A 4x16mm <sup>2</sup> (bistek)	m	1	€ 12.00	€ 12.00	
10	Furnizimi dhe vendosja e kabllos XOO/O-A 2x16mm <sup>2</sup> (bistek)	m	1	€ 9.70	€ 9.70	
				TOTALI :		101.70



PJEZA B (30%)						
Nr.	TITULLI: Mirëmbajtja e ndricimit publik në Komunën e Decanit për vitin 2024 deri më 2026	Njësi	Sasi	Cmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali i mirëmbajtjes (30% e pikave per vireshim)	Totali i me TVSh-€
1	PJEZA B					
1	Bartë e dites ekzistuese se bashku më lire nga shtylla e vjetër ne shtyllë te re te betonit	Copë	1	€ 15.00	€ 15.00	
2	Boratë e kabilos nga shtyllat e vjetra ne shtyllat te reja	m-	1	€ 3.00	€ 3.00	
3	Furnizimi dhe montimi i Unazave per shtylla	Copë	1	€ 3.00	€ 3.00	
4	Furnizimi dhe montimi i klemave kafshive FIDOS	Copë	1	€ 1.80	€ 1.80	
5	Furnizimi dhe montimi i shëngueseve të kabilos	Copë	1	€ 0.60	€ 0.60	
6	Furnizimi dhe montimi i mbajtseve të kabilos	Copë	1	€ 0.20	€ 0.20	
7	Furnizimi dhe montimi i shtyllave të betonit 9/315	Copë	1	€ 20.00	€ 20.00	
8	Ormanet furnizues -ndërmjet ormaneve te vjetra te cilat nuk janë jene ne gjendje te mire pune, punohen sipas urdhreses. Furnizimi me kuadër kryesor shpëmarrës (Ormanë) që me elementet kyqese, të mbrendshme të dhura - komplet (për ndiqim të jashtëm me tri dale), me ndërpërës kryesore që të vendoset në bazament të betonit (1.2x0.9x0.3), i punitur me larmorin dyfishtë dekaptuar me trashësi 2.5 mm me izolim IP65, me profile te presuara që kapakë te lyer me ngjyrë mbrojtëse, antikorrizeve që ndihmojnë kapakët te ketë xhamin përmes lekujtar njësorë. - Ormani duhet te ketë skemën njëpolicë të vendosur brenda, numrin e ormanit si dhe shenjen e rezikut te vendosur jashtë. - Njësorë elektrikë 3x230/400V, 1 copë bartet ajr ekzistuese nga ormani furnizues i vjetër Gjitha pajisjet tjera elektrike duhet ti përshtaten standardeve përkate të Evropiane.	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
9	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 16A	Copë	1	€ 0.20	€ 0.20	
10	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 25A	Copë	1	€ 0.20	€ 0.20	
11	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 32A	Copë	1	€ 0.20	€ 0.20	
12	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 40A	Copë	1	€ 0.30	€ 0.30	
13	Furnizimi dhe montimi i siguresave automatike 63A	Copë	1	€ 0.30	€ 0.30	
14	Furnizimi dhe montimi i siguresave 3 polëshe 63A	Copë	1	€ 1.00	€ 1.00	
15	Furnizimi dhe montimi i siguresave 3 polëshe 40A	Copë	1	€ 1.00	€ 1.00	
16	Furnizimi dhe montimi i siguresave 3 polëshe 32A	Copë	1	€ 1.00	€ 1.00	
17	Furnizimi dhe montimi i siguresave 3 polëshe 25A	Copë	1	€ 1.00	€ 1.00	
18	Furnizimi dhe montimi i siguresave 3 polëshe 16A	Copë	1	€ 1.00	€ 1.00	
19	Mbojje diferenciale FID 63/0.03A	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
20	Mbojje diferenciale FID 40/0.03A	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
21	Mbojje diferenciale FID 25/0.03A	Copë	1	€ 4.00	€ 4.00	
22	Furnizimi dhe montimi i rejeve kohore me rregulim	Copë	1	€ 2.00	€ 2.00	
23	Furnizimi dhe montimi i prizave njefazore njëshe të vendosura në mur me kuti Ø60 komplet	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
24	Furnizimi dhe montimi i prizave njefazore dyshë të vendosura në mur me kuti Ø60 komplet	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
25	Furnizimi dhe montimi i prizave trefazore	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
26	Furnizimi dhe montimi i prizave njefazore OG	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
27	Furnizimi dhe montimi i ndërpërësit njëpolari	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
28	Furnizimi dhe montimi i ndërpërësit serik	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
29	Furnizimi dhe montimi i ndërpërësit alternativ	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
30	Furnizimi dhe montimi i ndërpërësit kryqezor	Copë	1	€ 0.50	€ 0.50	
31	LED panel 48W 60x60 cm OG	Copë	1	€ 7.00	€ 7.00	
32	LED panel 36W 25x25cm OG	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	



33	Furnizimi dhe montimi i kontaktorëve 16A	Copë	1	€	4.00	€	4.00
34	Furnizimi dhe montimi i kontaktorëve 25A	Copë	1	€	4.00	€	4.00
35	Furnizimi dhe montimi i kapakeve metalik te shtyllave (9m dihe 10m)	Copë	1	€	0.50	€	0.50
36	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PPY 3x1.5 mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.20	€	0.20
37	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PPY 3x2.5 mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.20	€	0.20
38	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PPY 5x1.5 mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.30	€	0.30
39	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PPY 5x2.5 mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.30	€	0.30
40	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PPY 5x4 mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.40	€	0.40
41	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PP00 3x2.5mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.20	€	0.20
42	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PP00-A 4x16mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.30	€	0.30
43	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PP00-A 4x25mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.40	€	0.40
44	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PP00-A 4x36mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.40	€	0.40
45	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PP00-A 4x50mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.40	€	0.40
46	Furnizimi dhe vendosja e kabllos PP00-A 4x70mm <sup>2</sup>	m	1	€	0.50	€	0.60
47	Furnizimi dhe montimi i papuheve (25-35)mm	Copë	1	€	0.20	€	0.20
48	Furnizimi dhe montimi i papuheve 50mm	Copë	1	€	0.20	€	0.20
							99.30



PJESA C (20%)						
Nr.	TITULI : Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Deçanit, për vitin 2024: deri me 2026	Njësie	Nosat	Gjimi per njësi (me TVSh) €	Totali i mirmbajtjes (20% e pikave per vleresim)	Totali i me TVSh/C
1	PJESA C					
1	Hapja e gropes, montimi i 1.5m gyp Ø400 dhe betonimi	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
2	Betonimi i bazamentit të shtyfës së ndriçimit 80x80x90 cm mebeton MB30	Copë	1	€ 5.00	€ 5.00	
3	Hapja e kanalit 40x80 cm	m	1	€ 0.20	€ 0.20	
4	Thyerja e betoroste asfaltit që kthimi ne gjendje te mëparshme	m	1	€ 0.20	€ 0.20	
5	Prija e asfaltit ose betonit	m	1	€ 0.20	€ 0.20	
6	Furnizimi dhe vendosja e shirit paralajmues	m	1	€ 0.05	€ 0.05	
7	Furnizimi dhe vendosja e shirit Fe-Zn 25x4mm	kg	1	€ 0.30	€ 0.30	
8	Furnizimi dhe vendosja e shirit Fe-Zn 20x3mm	kg	1	€ 0.30	€ 0.30	
9	Furnizimi dhe montimi i lëkësive të tokezimit	Copë	1	€ 0.20	€ 0.20	
10	Furnizimi dhe punimi i lëkësive kablike (muflave) 10-16mm	Copë	1	€ 3.00	€ 3.00	
11	Furnizimi dhe punimi i lëkësive kablike (muflave) 25-70mm	Copë	1	€ 3.00	€ 3.00	
12	Furnizimi dhe montimi i kablos bistek 4x50.mm	m	1	€ 0.30	€ 0.30	
13	Punime me karpe	h	1	€ 30.00	€ 30.00	
TOTALI 3:						47.75

Rekapitulimi	Peshimi (%)	gjimi total i peshuar
PJESA A (50%)	50%	101.70
PJESA B (30%)	30%	99.30
PJESA C (20%)	20%	47.75
QUMIMI TOTAL I PESHUAR	100%	90.19

